



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Nr. ____ Prot.

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2023

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2024 - 2026 TË BASHKISË SË SHKODRËS

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, 34, 40, 41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar ; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; projektligjit "Për buxhetin e vitit 2023"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 06 datë 28.02.2023 “Per përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 21 datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Shkreses së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 20079 date 03.11.2023 “ Dergohet për njoftim Transferta e Pakushtezuar e Pergjithshme per vitin 2024 “ , Akti normativ nr. 6 date 14.12.2023 i Keshillit te Ministrave "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 84/2022 "Per buxhetin e vitit 2023" te ndryshuar dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër

V E N D O S I:

1. Të miratojë buxhetin e vitit 2024 dhe programin buxhetor afatmesem përfundimtar për vitet 2024 - 2026, të Bashkisë së Shkodrës, si më poshtë:
 - a) Të miratojë tavanet për çdo program, për vitin 2024 - 2026 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës 1 dhe programeve buxhetore të detajuara , pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- b) Të miratojë të ardhurat sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme, sipas tabelës 2 , pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - c) Të miratojë detajimin e shpenzimeve sipas klasifikimeve buxhetore për vitet 2024-2026 sipas tabelës 3-5,4,4.1 dhe programeve buxhetore te detajuara sipas klasifikimit ekonomik, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - d) Të miratojë qellimet /objektivat/produktet për çdo program, për vitin 2024 - 2026 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës 6,7,9 dhe programeve buxhetore te detajuara , pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - e) Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program, sipas tabelës 8 , pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - f) Të miratojë fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2024-2026 , të ndara në korrente dhe kapitale; sipas tabelës 10 , pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - g) Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve në varësi për vitin 2024, sipas tabelës nr. 11, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Tabelat shoqeruese:
- a) Llogaritja e efektit financiar të lehtësimeve fiskale vendore, tabela nr.12, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b) Lista e njërive shpenzuese të bashkisë Shkoder, sipas tabelës nr. 13 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - c) Një përmbledhje të të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të bashkisë, sipas tabelës nr. 14 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - d) Projektin e parë të planit të arkës të të ardhurave të veta të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026 , sipas tabelës nr. 15 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - e) Një përmbledhje të pagesave të vonuara ndaj palëve të treta, përfshirë edhe origjinën e tyre dhe masat për likuidimin e parandalimin e krijimit të tyre, sipas tabelës nr. 16 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Fondet e papërdorura në fund te vitit 2023, me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike dhe të ardhurat e veta, do të jene pjesë e buxhetit te vitit 2024.
4. Është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë:
- a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program;
 - b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program;
 - c) Rishpërndarja brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njërive të ndryshme shpenzuese.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

Zv. Kryetar

Rushi Belis

Zv. Kryetar

Amid Dji

Zv. Kryetar

Drejtoria e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

Enkel Hoxha

Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së
investimeve të Infrastrukturës

Alfred Lulë

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Per: Andri Kroye

Drejtoria e Ndihmes Ekonomike dhe Personave
me Aftësi Ndryshe

Adoret Vjeka

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse

Arbete Rexhepi

Drejtoria e te Ardhurave

Flori Bledi

Drejtoria e Financës

Blerta Nicolescu

Drejtoria Juridike

Bechira Japari

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Belum Nema


Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Arbete Kroye

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit
të Ujërave


Ida Silla

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
trajtimit të AMTP



Drejtoria e Turizmit


Drejtoria e Studimeve, Planifikimit,
Koordinimit të Investimeve



Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të
Territorit



Policia Bashkiake



Drejtoria e Administrimit të Sistemeve
Menaxhimit të ZIN, Projekteve dhe
Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit

